



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2021

**V E N D I M**

**Nr. 126, datë 05 / 07 / 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 15, datë 18.02.2021, e z. M.Z., ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes familjare, nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se z. M.Z. është banor në Yzberisht, Tiranë prej shumë vitesh. Në vitin 2006, ai ka ndërtuar në këtë zonë, përkatësisht në Njësinë Administrative nr. 6, një objekt pa leje, për të cilin ai sqaron se ka depozituar kërkesën nr. 17 prot., datë 04.08.2006 për legalizimin e këtij objekti informal. Ankuesi pretendon se edhe pse kanë kaluar 15 vjet, ai ende nuk ka fituar pronësinë mbi objektin e sipërpërmendur.

M.Z. pretendon se zvarritja e procedurave për legalizimin e ndërtesës së tij të banimit është diskriminim, që atij po i bëhet për shkak të racës rome, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike.

**II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>1</sup>, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak për shkak të gjendjes ekonomike dhe gjendjes familjare, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 15, datë 18.02.2021, e z. M.Z., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

**B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>2</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me shkresën nr. 283/2, datë 22.02.2020, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:

1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit M.Z.;
2. Informacion lidhur me procedurat e ndjekuara mbi rastin e ankuesit, si dhe të evidentohen arsyet e mos kryerjes së legalizimit të banesës së tij nga viti 2006, deri në vitin 2020;
3. Kopje e korrespondencës zyrtare të institucionit, me ankuesin përgjatë periudhës 2006-2020;
4. Kopje e praktikës së legalizimit, që administrohet institucioni mbi ndërtesën objekt legalizimi;
5. Informacion mbi banorë të tjerë, të kësaj zone që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë depozituar kërkesë për legalizim pranë institucionit tuaj, në të njëjtën periudhë kohore (2006-2007) me ankuesin;
6. Informacion mbi faktin se sa prej këtyre objekteve janë legalizuar. Të dërgohen kopje të akteve përkatëse të legalizimit;
7. Informacion mbi banorë të tjerë, të kësaj zone që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, kanë depozituar kërkesë për legalizim pranë institucionit tuaj në periudhën kohore 2010-2020 dhe objektet e tyre janë legalizuar; Bashkëlidhur të dërgohen kopje të akteve të legalizimit.

- Në përgjigje të shkresës nr. 285/2, datë 22.02.2020, së KMD-së, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, pranë Drejtorisë Shtetërore të Kadastrës, dërgoi shkresën nr. 1444/1, datë 09.03.2021, nëpërmjet së cilës informon se mbështetur në verifikimet e kryera rezultoi se pranë këtij institucioni administrohet praktika e legalizimit me vetëdeklarim nr. 17 prot., datë 04.08.2006, në emër të Mustafa Demir Zeqirit.

Në shkresë theksohet fakti se për efekt të trajtimit të praktikës së M.Z. në respektim të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria Vendore Rurale 2 Tirana i është drejtuar Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 1789 prot., datë 05.03.2021, për të vendosur të dispozicion informacionin, nëse objekti informal i vetëdeklaruar nga z. M.Z. preket nga zbatimi i ndonjë projekti konkret i infrastrukturës rrugore në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor të kësaj bashkie, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 14.04.2017.

---

<sup>2</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Në shkresë sqarohet se Agjensia Shtetërore e Kadastrës mbetet në pritje të përgjigjes zyrtare të Bashkisë Tiranë për të vazhduar në vijim procedurat sipas VKM nr.1040, datë 25.11.2020 *“Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje.”*

Në lidhje me pikat e tjera në kërkesën e KMD-së, sqarohet se nëpërmjet ligjit nr. 111/2018 *“Për Kadastrën”* është krijuar Agjensia Shtetërore e Kadastrës dhe nëpërmjet Urdhërit nr. 470, datë 06.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm *“Për përcaktimin e kompetencës së disa Drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës”*, janë përcaktuar kompetencat e Drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës.

Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 nuk administron korrespondencën zyrtare të ish-Drejtorive Rajonale të Aluizmit ndër vite, si dhe nuk administron dokumentacionin tekniko-ligjor për praktikatat e legalizimit të banorëve të tjerë, për të cilët kanë përfunduar procedurat administrative të legalizimit të ndërtimeve.

1. Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës me shkresën nr. 283/3, datë 16.04.2021, nëpërmjet së cilës kërkohet informacion mbi faktin, (1) nëse Bashkia Tiranë ka dërguar informacion zyrtar pranë Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, nëse objekti informal i vetëdeklaruar nga z. M.Z. preket nga zbatimi i ndonjë projekti konkret të infrastrukturës rrugore në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor të kësaj bashkie. Nëse po, të dërgohet kopje e shkresës së Bashkisë Tiranë, si dhe (2) Informacion se si do të procedohet në vijim me legalizimin e objektit informal të vetëdeklaruar nga z. M.Z..

- Në përgjigje të shkresës nr.283/3, datë 16.04.2021, të KMD-së, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 dërgoi shkresën nr. 1443/3, datë 27.04.2021, nëpërmjet së cilës informon se mbështetur në shkresën nr. 10546/1, datë 18.03.2021, e Bashkisë Tiranë rezulton se territori, ku pozicionohet objekti informal i M.Z., preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 14.04.2017.

Në respektim të ligjit nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”*, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Rurale 2 nuk mund të vijojë me procedurat administrative të legalizimit për këtë objekt informal.

Bashkëlidhur shkresës nr. 1443/3, datë 27.04.2021, është dërguar edhe një kopje e shkresës nr. 10546/1, datë 18.03.2021, së Bashkisë Tiranë.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 404/3, datë 24.05.2021, të KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 21.06.2021, ora 10:00**, pranë Zyrës së KMD-së. Në këtë seancë u ftua për pjesëmarrje edhe Drejtoria e Përgjithshme e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës. Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2 iu kërkua të depozitonte në seancë informacionin e mëposhtëm:

1. Informacion mbi banorë të tjerë, të së njëjtës zonë me ankuesin, që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, kanë depozituar kërkesë për legalizim në periudhën kohore 2006-2017 dhe objektet e tyre janë legalizuar. Bashkëlidhur depozitohen kopje të akteve të legalizimit;
2. Informacion mbi arsyen e mos legalizimit të ndërtimit informal të z. M.Z. para vitit 2017;

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi dhe përfaqësuesi i tij ligjor, si dhe përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës. Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 nuk dërgoi përfaqësues në këtë seancë, e cila u zhvillua në mungesë të saj.

Pala ankuese parashtroi edhe një herë pretendimet e saj për diskriminim për shkaqet e parashtruara në ankesë. Gjatë seancës dëgjimore, ajo u njoh mbi faktin se legalizimi i këtij objekti nuk mund të kryhej pasi territori, ku pozicionohet objekti informal i M.Z., preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, datë 14.04.2017.

Në vijim, subjekti ankues ngriti pretendimin se përse ky objekt nuk ishte legalizuar para vitit 2017, vit në të cilin është miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë. Njëkohësisht, pala ankuese pretendoi dhe e vuri theksin tek zgjatja e afatit për legalizimin e objektit informal të deklaruar nga M.Z., si dhe mungesën totale të informacionit nga ana e organit administrativ. Përfaqësuesi ligjor i ankuesit pretendoi se objektet informale të fqinjëve të ankuesit janë legalizuar, ndërkohë që objekti informal i ankuesit nuk është legalizuar. Ai pretendoi se shkak për këtë mosveprim të autoritetit përkatës është subjekti kundër së cilit drejtohej ankesa. I pyetur nëse ankuesi ka depozituar kërkesë me shkrim për informacion, përfaqësuesi u shpreh se ankuesi është paraqitur fizikisht disa hera pranë Aluiznit, por në asnjë rast nuk ka marrë informacion. Ai theksoi faktin se informacioni fillestar është dhënë pas ankimimit tek KMD. I pyetur nëse pjesa e ndërtesave informale fqinje të legalizuara i përkasin apo jo anëtarëve të komunitetit egjiptian, përfaqësuesi ligjor i ankuesit u shpreh se *“një nga dyshimet është se ata nuk i përkasin komunitetit dhe pjesa e legalizimeve i përket maxhorancës”*.

Përfaqësuesi i ASHK-së u shpreh se ishte organ epror i Drejtorisë Tirana Rurale 2, por nuk administron apo shqyrton dosje, si dhe nuk disponon prova konkrete mbi ratin në shqyrtim. Ai përjashtoi mundësinë e diskriminimit për shkak të racës, pasi këto institucione nuk disponojnë informacion mbi racën e deklaruësve. Ai u shpreh se në momentin që ankuesi ka bërë kërkesë

zyrtare, ASHK i ka kthyer përgjigje atij. Ai theksoi faktin se nuk mund të provohet nëse ankuesi është paraqitur pranë Aluiznit, për të marrë informacion. Ai theksoi faktin se procesi i legalizimit është një proces që zgjat shumë në kohë, si dhe vuri në dukje se në vitin 2018, ka ndodhur një riorganizim apo shkrirje në një institucion të vetëm të institucioneve të Aluiznit dhe hipotekës. I pyetur nëse ka deklarime të tjera të vitit 2006 pa u legalizuar, përfaqësuesi i ASHK u shpreh se ka shumë të tilla. ASHK u ka kërkuar zyrtarisht Drejtorive Rajonale të vepronjë dhe të kenë prioritet legalizimet e deklarimeve të viteve 2005-2006. Një pjesë e mirë e tyre janë kryer dhe shumë të tjera janë ende në proces për arsye të ndryshme, por në asnjë rast nuk ka diskriminim. Ai u shpreh se Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 ka kompetencë të japë shpjegime mbi shkaqet e zvarritjes së praktikës së M.Z.. I pyetur mbi faktin se a ka detyrim Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 të japë informacion mbi arkivat e ish-Aluiznit dhe se ku gjendeshin këto arkiva, përfaqësuesi i ASHK u përgjigj se pas shkrirjes së ish-Aluiznit dhe zyrave të hipotekave, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 ka marrë në ngarkim të gjitha dosjet që i përkisnin në bazë të kompetencës territoriale. Njëkohësisht, përfaqësuesi i ASHK u shpreh se kjo drejtori ka detyrim të kthejë përgjigje, në lidhje me çështje që janë trajtuar nga ish-Aluizni, pasi mund të ketë akses në arkiva edhe në rast se ato mund të mos i disponojë vetë, por mund t'i kërkojë dosjet pranë drejtorive të tjera.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e KMD-së iu drejtuan përfaqësuesit ligjor të ankuesit dhe e pyetën nëse kishte dijeni mbi një sërë shkresash që Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, apo institucioni paraardhës i kishte drejtuar ankuesit, pasi ato ishin dorëzuar në cilësi prove pranë KMD-së. Ai u përgjigj se po ankohej për faktin se Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 apo ish-Aluizni nuk ka dërguar asnjëherë shkresë zyrtare për të njoftuar aplikuesin në ç'fazë ndodhej legalizimi dhe cilat procedura ishin kryer.

Përfaqësuesit e KMD-së sqaruan se do të ishte e nevojshme që nëse pala ankuese do të kishte informacion të saktë lidhur me legalizimet e kryera nga fqinjët e ankuesit, si dhe mbi faktin nëse ata i përkisnin komunitetit egjiptian ose jo, për efekt të hetimit administrativ, ky informacion të dërgohej pranë KMD-së.

Përfaqësuesi i ASHK u shpreh se pala ankuese duhet të vërtetojë se ka depozituar kërkesë më shkrim pranë Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2 dhe ata nuk i kanë kthyer përgjigje, pasi për shkak të ngarkesës tepër të madhe në punë është e pamundur që çdo aplikant të njoftohet mbi fazën në të cilën ndodhet procesi i legalizimit. Drejtoritë përkatëse vepronjë dhe procedojnë sipas blloqeve kadastrale, mbi bazën e një planeve të veprimit, që këto drejtori miratojnë, si dhe sipas kërkesave të qytetarëve.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, nëpërmjet shkresës nr. 795 prot., datë 26.05.2021, ku kërkohej informacioni i mëposhtëm:

- Informacion mbi banorë të tjerë, të së njëjtës zonë me ankuesin, që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, kanë depozituar kërkesë për legalizim në periudhën kohore 2006-2017



dhe objektet e tyre janë legalizuar; Bashkëlidhur depozitohen kopje të akteve të legalizimit;

- Informacion mbi arsyen e mos legalizimit të ndërtimit informal të z. M.Z. para vitit 2017;
- Planet e veprimit për vitet 2019-2021, të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2;
- Informacion mbi bllokun kadastral, ku ndodhet objekti informal i deklaruar nga ankuesi. Të përcaktohet numri i legalizimeve në këtë bllok kadastral nga viti 2006-2017, duke i kategorizuar për secilin vit, si dhe numri i objekteve informale ende të palegalizuara në këtë bllok kadastral;

Në shkresën e sipërcituar u vu në dukje fakti se kërkesa e Komisionerit mbështetej në informacionin e dhënë nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës në seancë dëgjimore, si dhe aktet dhe informacioni përkatës, të siguroheshin nga dokumentacioni i administruar nga ish-Drejtoritë Rajonale të Aluiznit. Shkresa e sipërcituar iu dërgua për dijeni palës ankuese dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës.

- Në përgjigje të shkresës nr. 795 prot., datë 26.05.2021, së KMD-së, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 dërgoi shkresën nr. 1444/4, datë 14.06.2021, nëpërmjet së cilës informon mbi çështjet, për të cilat KMD kërkon informacion.

Lidhur me çështjen e parë dhe të dytë, të parashtruar në shkresën nr. 795 prot., datë 26.05.2021, e KMD-së, sqarohet se mbështetur në nenet 9 dhe 45/3, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, duke qenë se mbrojtja e konfidencialitetit është një detyrim ligjor i sanksionuar në ligj, dhënia e dokumentacionit mund të kryhet vetëm ndaj subjekteve që janë pronarë, ose që provojnë se kanë interes të ligjshëm mbi pasurinë.

Nëpërmjet ligjit nr. 111/2018 *“Për Kadastrën”* është krijuar Agjensia Shtetërore e Kadastrës dhe nëpërmjet Urdhërit nr. 470, datë 06.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm *“Për përcaktimin e kompetencës së disa drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës”* janë krijuar dhe përcaktuar kompetencat e Drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, ndër të tjera dhe të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, e cila është krijuar rishtazi dhe nuk disponon informacion, si dhe nuk administron dokumentacion mbi arsyet e mos legalizimit për objektin e z. M.Z., për periudhën para vitit 2017.

Lidhur me çështjen e tretë, KMD informohet se planet e veprimit për periudhën 2019-2021 janë marrë nga Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, mbi bazën e verifikimit të ndërtimeve informale duke kryer evidentimin faktik në terren, sipas njësisive strukturore “bllok kadastral”, në zbatim të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020 *“Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”*.

Ndërsa, në lidhje me kërkesat e pikës së katërt, në bazë të verifikimit të kryer pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës rezulton se numri total i lejeve të

legalizimit të emetuara për periudhën 2006-2017, për zonën kadastrale 3866 është 779 të tilla, nga ku leja e parë rezulton prej datës 23.02.2009.

Në shkresë theksohet fakti se rasti i ankesës së z. M.Z. është i njëjtë me atë të z. Mondi Zeqiri dhe Hamdi Zeqiri, për të cilët KMD është shprehur me vendim konstatim mosdiskriminimi, për shkaqet e pretenduara në ankesa.

Njëkohësisht, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 sqaron se për objektin informal të z. M.Z. janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, në përputhje me shkresën nr. 10546/1 prot., datë 18.03.2021, të Bashkisë Tiranë, ku jepet informacion mbi faktin se territori, ku pozicionohet objekti informal i z. M.Z. preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë. Z. M.Z. është informuar mbi këtë fakt, nëpërmjet shkresës nr. 2663/1 prot., datë 21.04.2021, nga Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale 2.

#### **A. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

##### **1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

Ankuesi M.Z. është banor në Yzberisht, Tiranë, i cili ka ndërtuar në vitin 2006 një objekt banesë pa leje ndërtimi në Njësinë Administrative nr. 6. Në vijim, ai ka depozituar vetëdeklarimin nr. 3434 prot., datë 20.03.2005<sup>3</sup> dhe vetëdeklarimin nr. 17, datë 04.08.2006, për legalizimin saj. Ankuesi pretendon se edhe pse kanë kaluar 15 vjet, ai ende nuk ka fituar pronësinë mbi objektin e sipërpërmendur. M.Z. pretendon se zvarritja e procedurave për legalizimin e ndërtesës së tij të banimit është diskriminim, që atij po i bëhet për shkak të racës rome, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike. Ankuesi M.Z. kërkon gjithashtu ndërhyrjen e Komisionerit, për të përfituar legalizimin e banesës së tij.

Për sa më sipër, rezulton se vetëdeklarimet e ankuesit M.Z. janë depozituar pranë ish-Aluiznit, Drejtorisë Rajonale Tiranë, e cila ka funksionuar deri në vitin 2018, periudhë në të cilën u miratua ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, nëpërmjet së cilit është krijuar Agjensia Shtetërore e Kadastrës, e cila ndër të tjera mori edhe funksionet e ish-Aluizmit. Ndërkohë që, nëpërmjet Urdhërit nr. 470, datë 06.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës, “Për përcaktimin e kompetencës së disa Drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës” janë përcaktuar gjithashtu edhe kompetencat e Drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, të

---

<sup>3</sup> Referuar shkresës nr. 1444/1, datë 09.03.2021, së Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë ASHK, rezulton se z. M.Z. ka depozituar dy vetëdeklarime, përkatësisht në vitin 2005 dhe 2006, sikurse është cituar më sipër;



cilat do të shqyrtojnë në vijim kërkesat për legalizim të objekteve informale, të cilat ishin ende të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale të Aluiznit.

Në referencë të nenit 5, të Ligjit nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proçeseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK) është institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kadastrën. ASHK është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proçeseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Nga korrespondenca zyrtare e KMD-së me Drejtorine Vendore Tirana Rurale 2, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, rezulton se Bashkia Tiranë e ka informuar këtë institucion nëpërmjet shkresës nr. 10546/1, datë 18.03.2021, se territori ku, pozicionohet objekti informal i M.Z., preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.

Në pikën 5, gërma a), të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” parashikohet shprehimisht: “5. Legalizimi i ndërtimeve pa leje nga drejtoritë vendore të ASHK-së bazohet në gjendjen faktike të tyre dhe në kriteret e përcaktuara në mënyrë shtetërore në këtë vendim. Për efekt të procedurave kualifikuese, drejtoritë e ASHK-së bashkëpunojnë me institucione të tjera, duke iu përmbajtur parashikimeve të këtij vendimi. Institucionet janë të detyruara të shprehen mbi kërkesat e drejtorive vendore të ASHK-së brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre. Në rast moskthimi të përgjigjes brenda këtij afati, ASHK-ja njofton organin epror të institucionit dhe/ose Kryeministrin.

Dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit merren parasysh gjatë procedurës së kualifikimit vetëm për ato elemente, kushte apo kritere dhe vetëm në ato raste që janë të parashikuara shprehimisht në këtë vendim.”

Në pikën 15, gërma c), të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” parashikohet shprehimisht: “Ndërtimi pa leje i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar ose zonës urbane, i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, nuk legalizohet nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtëme:..... c) Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore, ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit;”

Në këto kushte, për sa kohë që ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim, preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, në bazë të pikës 15, gërma c), të VKM nr. 1040/2020, procesi i legalizimit nuk është vazhduar më tej nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2.

Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, e cila është marrë me shqyrtimin e kërkesës së ankuesit për legalizim, e ka bërë me dije z. M.Z., lidhur me sa më sipër, nëpërmjet shkresave nr. 663, datë 21.04.2021, dhe shkresës nr. 1443/3, datë 27.04.2021.

Nga analizimi i fakteve të sipërcituara rezulton se legalizimi i objektit informal të deklaruar për legalizim nga ana e z. M.Z. nuk mund të kryhet, pasi ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim, preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 14.04.2017.

Në këto kushte, lind natyrshëm pretendimi i ankuesit, se përse legalizimi i objektit informal të deklaruar nga ana e tij nuk është kryer para vitit 2017, pasi vetëdeklarimi i tij i fundit është depozituar në muajin gusht të vitit 2006, pranë ish-Aluiznit, Drejtoria Rajonale Tiranë, pra rreth 11 vite më parë se të miratohej Plani i Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.

Referuar parashikimit të nenit 6, pika 1 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK) është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që krijohet me këtë ligj dhe funksionon si institucion me vetëfinancim.

Në nenin 67 të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht:

- “1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet si bashkim i AITPP-së, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së.*
- 2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*
- 3. Pas krijimit të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjensisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjensisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i ngarkohen ASHK-së.”*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se pavarësisht faktit se në vitin 2018, është kryer një riorganizim institucional, duke krijuar institucionin e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive të saj rajonale, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të suprimuara janë trashëguar tek institucionet e reja. Janë pikërisht Drejtoritë rajonale të ASHK-së që shqyrtojnë dosjet e deklarimeve të pashqyrtuara nga ana e Ish-Aluiznit.

Zvarritja e kryerjes së legalizimit të objektit informal të deklaruar nga z. M.Z. nga viti 2006 deri në vitin 2021 është tej çdo afati ligjor të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore. Kjo

zvarritje shumëvjeçare i ka kushtuar ankuesit në heqjen e mundësisë të legalizimit të këtij objekti, pasi në vitin 2017, me miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, ndërtesa e tij informale preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në këtë Plan.

Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të sipërcituar, Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, të ASHK.

### **A. Shkak i mbrojtur.**

Në ankesën nr. 15, datë 18.02.2021, e z. M.Z. pretendohet diskriminim për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes familjare, nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës.

Në nenin 1, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Komisioneri gjykon se “raca”<sup>4</sup> konsiderohet shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si e tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që ankuesi e mbart atë. Nëpërmjet vërtetimit të datës 08.03.2021, të lëshuar nga ana e Qendrës për Advokim Social rezulton se ankuesi i përket komunitetit rom.

“Gjendja ekonomike” konsiderohet gjithashtu shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si e tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe janë depozituar prova që vërtetojnë gjendjen jo të mirë ekonomike të familjes së ankuesit. M.Z. ka depozituar në cilësi prove kopje aktit “Kartelë Personale e Punëkërkuarit të Papunë” për veten dhe bashkëshorten e tij, Nexhipe Zeqiri, ku vërtetohet se të dy janë punëkërkuar të papunë.

---

<sup>4</sup> Mbështetur në përkufizimin e ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI(2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b) “diskriminimin racor” përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”.

“Gjendja familjare” konsiderohet shkak i mbrojtur ligjërish, pasi gjen parashikim në nenin 1 të LMD, të ndryshuar. Ankuesi ka depozituar në cilësi prove, pranë KMD-së, një kopje të certifikatës së tij familjare, ku rezulton regjistrimi i tij dhe bashkëshortes së tij. Lidhur me këtë shkak, Komisioneri çmoi se nuk është konstatuar ndonjë veçori familjare e ankuesit, për të cilën, ai do të mund të diskriminohej nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nuk provohet se “*gjendja familjare*” është shkak i mbartuar nga ana e ankuesit.

## **B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura – raca dhe gjendja ekonomike.**

Gjatë analizimit të fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, si pasojë e zvarritjes disa vjeçare të procedurave të legalizimit të ndërtesës informale të deklaruar nga ana e z. M.Z..

Ankuesi pretendon se diskriminimi i pretenduar është për shkak të racës së tij rome dhe për shkak të gjendjes së tij, ekonomike.

Legjislacioni ndërkombëtar dhe ai shqiptar ofron mbrojtje të posaçme nga diskriminimi për shkak të racës dhe për shkak të gjendjes ekonomike për individët, që iu përkasin komuniteteve vulnerabël.

Sipas nenit 116, të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, “*Ndalimi i diskriminimit*”, përcakton se: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”<sup>5</sup>.

---

<sup>5</sup> Gjendja ekonomike përfshihet në opsionin “për çdo shkak tjetër”.

Direktiva 2000/43/EC e Këshillit të Bashkimit Evropian zbaton parimin e trajtimit të barabartë midis personave pa marrë parasysh origjinën racore ose etnike dhe kërkon si domosdoshmëri vendosjen e barazisë racore dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të saj.

Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”*.

Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet, në bazë të së cilave ndaj një individi mund të ketë diskriminim. Në nenin 1 të LMD, të ndryshuar, parashikohet mbrojtje nga diskriminimi, sipas një listë jo shterruese shkaqesh, ku bëjnë pjesë edhe *“raca“* dhe *“gjendja ekonomike“*. Në referencë të nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar *“Diskriminim”* është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Nëpërmjet parashikimit të nenit 20, pika 1, të ligjit të sipërpërmendur ndalohet diskriminimi, në fushën e të miravë dhe shërbimeve, për shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji. Në këtë nen parashikohet shprehimisht: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Mbështetur në frymën e parimet themelore të antidiskriminimit të akteve ndërkombëtare, parimet bazë të Kushtetutës dhe parashikimeve të LMD, të ndryshuar, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM nr. 1072 datë 23.12.2015, është një dokument i rëndësishëm i Qeverisë Shqiptare. Ky Plan, përfshin

politika specifike dhe masa konkrete, që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e objektivave, në sektorët respektivë dhe programet publike, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Në Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020), parashikohet integrimi i tyre në shoqëri, si dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve ndaj këtij komunitetit pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të përkatësisë në komunitetin ku bëjnë pjesë. Në këtë kontekst, përmendim faktin se në Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020), në Fushën e Politikës - *“Strehimi dhe Integrimi Urban”* parashikohet Objektivi 1: *Përmirësimi i mekanizmave që do të ndikojnë në lehtësimin e familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian për procedurat e legalizimit.*

Në kuadër të procesit të integrit të Shqipërisë në BE, Qeveria Shqiptare ka miratuar disa dokumenta, siç janë Plani Kombëtar i Integritit European 2015-2020, Udhërrëfyesi për plotësimin e 5 Prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, *“masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese”*. Përbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfyesin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për Romët/Egjiptianët si: regjistrimi civil, aksesin në drejtësi, arsimin, dialogun ndërkulturor, punësimin dhe përmirësimin i aftësive, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe integrimin urban dhe mbrojtjen sociale. Janë pikërisht këto fusha që kanë orientuar objektivat kryesore të përcaktuara në këtë dokument. Gjithashtu duke marrë parasysh angazhimet e përshkruara në dokumentin Udhërrëfyesin Plani i Veprimit jep një listë më të detajuar të aktiviteteve që do të zbatoheshin gjatë periudhës 2016-2020<sup>6</sup>. Ndër të tjera, Plani i Veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimin urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integrit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka theksuar vazhdimisht se mbrojtja e shtresave në nevojë dhe gëzimi i të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim duhet të jetë një ndër elementët kryesor i cili duhet të mbahet në konsideratë nga ana e institucioneve të cilët kanë rol të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës, apo integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.

Kodi i Procedurës Administrative (KPA)<sup>7</sup> dhe LMD, i ndryshuar, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë

<sup>6</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, fq. 1, 2.

<sup>7</sup> Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.



rast Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, e cila duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, disfavorizuese dhe të pabarabartë, për shkakun e pretenduar.

Neni 82, pika 2 i KPA, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS<sup>8</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>9</sup>

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankueses, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri gjykoi se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, e cila si pjesë e ASHK-së, si dhe në bazë të nenit 67, të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ka ngarkim të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike. Ankuesi ka depozituar deklarin e tij për legalizim të ndërtesës informale që në vitin 2006 dhe procedura e legalizimit është zvarritur për pothuajse

<sup>8</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

<sup>9</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

15 vjet. Vetëm në vitin 2021, pas fillimit të hetimit administrativ të Komisionerit, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 u vu në lëvizje për të proceduar mbi rastin e tij. Një zvarritje e tillë atij i ka kushtuar shumë, pasi aktualisht legalizimi i këtij objekti nuk mund të kryhet më, pasi me miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë në vitin 2017, ndërtesa e tij informale preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në këtë Plan.

Për sa më sipër, ankuesi ka depozituar pranë KMD-së në cilësi prove Vërtetimin e datës 08.03.2021, të lëshuar nga ana e Qendrës për Advokim Social, ku rezulton se ai i përket komunitetit rom. Njëkohësisht, referuar akteve të depozituara në cilësi prove, rezulton se ankuesi jeton me bashkëshorten e tij, dhe të dy janë punëkërkues të papunë. Në këto kushte, gjendja ekonomike familjare e tij nuk është e mirë.

Në analizë fakteve të mësipërme, Komisioneri gjykon se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga subjekti përkatës kundrejt ankueses dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt.

Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 nuk dërgoi pranë KMD-së informacionin e kërkuar që konsistente në të dhëna, lidhur me banorë të tjerë, të së njëjtës zonë me ankuesin, që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, kanë depozituar kërkesë për legalizim në periudhën kohore 2006-2017 dhe objektet e tyre janë legalizuar, informacion mbi arsyen e mos legalizimit të ndërtimit informal të z. M.Z. para vitit 2017 etj., edhe pse kishte barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e asaj që pretendonte ankuesi. Në këtë kontekst, Komisioneri thekson faktin se të dhënat e kërkuara nga KMD, u konsideruan si të dhëna të gjetshme dhe të administruara nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së, edhe nga ana e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së në seancë dëgjimore. Por, pavarësisht kësaj, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 nuk e dërgoi informacionin e kërkuar. Për të bërë të qartë situatën, Komisioneri i dërgoi zyrtarisht këtij institucioni, audion e seancës dëgjimore, në të cilën Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 mungoi dhe nuk dërgoi përfaqësues.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohej ankesa, duhet të përmbushte dy kushtet e përmendura më sipër. Komisioneri vlerëson se nga ana e këtij subjekti nuk u arrit të provohej që vërtetoheshin dy momentet e mëposhtëme:

1. Nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkaqeve të pretenduara nga ankuesi, që janë raca dhe gjendja ekonomike dhe trajtimit të padrejtë e disfavorshëm nga ana e subjektit, ose,
2. Për veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Komisioneri gjykon se mosdhënia e të dhënave të kërkuara nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, ka penguar kryerjen e hetimit administrativ për shqyrtimin e ankesës së M.Z.. Një veprim i tillë bie ndesh me nenin 32, pikat 2 dhe 4, të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet

shprehimisht se: “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.” “Detyrimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni përmbushet në përputhje me legjislacionin që rregullon të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”. Informacioni i kërkuar nga KMD nuk konsiderohet cënim i të dhënave personale, pasi në thelb kalimi i parcelave është objekt aktesh normative, që botohen në fletore zyrtare. Duke qenë se Drejtoria Rajonale Vendore Tirana 2 e disponon informacionin dhe ka detyrimin për ta vënë atë në dispozicion, sidomos një organi publik për trajtimin e një procedure administrative-hetimore, është e nevojshme të mbahet në konsideratë që informacioni i kërkuar lidhet me standartin e krahasimit që përdoret për çështjet, që lidhen me pretendime për diskriminim dhe trajtohet nga KMD duke respektuar gjithë legjislacionin për të drejtën e informimit dhe të dhënave personale.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se një fakt i tillë krijon bindjen, që ndodhemi para një situatë diskriminuese.

Gjithashtu, justifikimi i Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2 për mosdhënie informacioni bie në kundërshtim të plotë edhe me deklarinimin e përfaqësuesit të ASHK-së në seancë dëgjimore.

Për sa më sipër, KMD gjykon se M.Z. është diskriminuar për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të z. M.Z., për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha - Të mira dhe shërbime  
Shkak – raca, gjendja familjare dhe gjendja ekonomike  
Lloji i vendimit - diskriminim